



SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë

Shpallje për vend të lirë pune

PËRMBLEDHJE

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë në partneritet me Handikos-in – Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Kosovës është duke zbatuar një projekt të financuar nga BE-ja që menaxhohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, me titull: “Avansimi i kapaciteteve për të drejtat e fëmijëve”.

Projekti synon të kontribuojë në forcimin, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në shërbimet sociale dhe OSHC-ve që ofrojnë shërbime për fëmijë.

Objektivat kryesore të projektit janë: Rritja e aftësive dhe njohurive të QPS-ve dhe OSHC-ve për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e fëmijëve; Ofrimi i shërbimeve sociale për fëmijët në nevojë dhe familjet e tyre përmes ofrimit të shërbimeve psiko-sociale, këshillimit individual dhe grupor dhe shërbimeve të rehabilitimit; Promovimi dhe inicimi i qasjes multidisiplinare për të drejtat e fëmijëve dhe ngritja e kapaciteteve të qendrave të rehabilitimit me bazë në komunitet.

Për të arritur rezultatet e parashikuara në lidhje me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, është në kërkim të punësit të një **Koordinatori/eje të Projektit** me orar të plotë

| | |
|---------------------------------|---|
| POZITA: | Koordinator/e i/e Projektit |
| VENDI: | Prishtinë |
| ORARI I PUNËS: | Orar i plotë (40 orë në javë) |
| DATA E FILLIMIT: | Shtator 2022 |
| KOHËZGJATJA E KONTRATËS: | Deri në fund të projektit (31 janar 2023). |

Përmbledhje e përgjithshme për pozitën e punës:

Koordinatori/-ja i/e Projektit do të jetë përgjegjës/-e për mbikëqyrjen dhe koordinimin e projektit dhe aktiviteteve/shërbimeve të tij/saj duke përfshirë monitorimin, vlerësimin dhe raportimin. Ai/ajo do të sigurohet që qëllimi i projektit të jetë i shëndoshë, duke raportuar rregullisht mbi ecurinë e projektit dhe duke siguruar që projekti është në hap me orarin e miratuar.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Mbikëqyr zbatimin e përgjithshëm të projektit, duke përfshirë progresin lidhur me planin vjetor dhe kornizën logjike dhe buxhetin e tij;
- Koordinon aktivitetet dhe shërbimet e projektit si dhe zbatimin e aktiviteteve të caktuara dhe zhvillimin e planeve dhe ndërhyrjeve, së bashku me një partner/-e;
- Monitoron zbatimin e projektit nëse është në përputhje me kërkesat e donatorëve dhe siguron koordinim me të gjithë përfituesit në fazën e zbatimit;

- Siguron që projekti të arrijë objektivat e tij të parashikuara me objektivat e përgjithshme dhe specifike, rezultatet, dhe treguesit e outputeve;
- Siguron që aktivitetet e projektit të kryhen në kohë, përfshirë ato që do të zbatohen në bashkëpunim me një partner/-e.
- Shërben si ndërmjetës/-e për të gjitha komunikimet ndërmjet përfituesve dhe donatorit;
- Ka përgjegjësi të plotë financiare për të siguruar që projekti të zbatohet në përputhje me kërkesat e donatorit;
- Bën ndërlidhjen me institucionet e qeverisjes lokale dhe qendrore për të siguruar arritjen e rezultateve të projektit,
- Përgatit dhe përditëson planin e punës, raportet mujore, tremujore dhe vjetore, në bashkëpunim me partnerin/-en dhe siguron raportimin në kohë tek donatori;
- Informon donatorin për çfarëdo ngjarje që mund të ndikojë në ose vonojë zbatimin e projektit;
- Siguron që të regjistrat dhe dokumentet zyrtare janë të mirëmbajtura në përputhje me rrethanat, dhe që dokumentet e projektit dhe zbatimi të jenë në harmoni me rregullat dhe udhëzimet e BE-së, legjisllacionin kombëtar dhe praktikat më të mira ndërkombëtare;
- Është përgjegjës/-e për ofrimin e të gjitha dokumenteve dhe informacioneve për donatorin, veçanërisht në lidhje me raportet narrative dhe kërkesat për pagesa;
- Kryen detyra të tjera siç kërkohet nga mbikëqyrësi/-ja.

Mbrojtja e Fëmijëve (CS):

- Është përgjegjës/-e brenda fushës së punës për të parandaluar dhe mbrojtur fëmijët nga çfarëdo forme e abuzimit, braktisjes, shfrytëzimit, dhunës dhe diskriminimit bazuar në parimet e politikës së SOS për Mbrojtjen e Fëmijëve
- Është përgjegjës/-e të raportojë çdo dyshim, shqetësim, pretendim ose incident lidhur me mbrojtjen e fëmijëve menjëherë, duke ndjekur procedurat e raportimit të mbrojtjes së fëmijëve. Raportet e mbrojtjes së fëmijëve duhet të paraqiten tek personi kontaktues (pika fokale) për mbrojtjen e fëmijëve, ose tek çdo anëtar tjetër i ekipit kombëtar për mbrojtjen e fëmijëve dhe/ose tek menaxheri përkatës i linjës.

Njohuritë dhe përvoja:

- Diplomë universitare në Administrim Biznesi, Ekonomi, Juridik, Shkenca Sociale, apo fusha të ngjashme;
- Të paktën 3 vite përvojë pune në pozita të ngjashme brenda shoqërisë civile, organizata, veçanërisht në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut;
- Përvojë e dokumentuar në zbatimin, koordinimin, monitorimin dhe vlerësimin e ciklit të projektit lidhur me këtë sektorë;
- Aftësi të shkëlqyeshme menaxheriale, përfshirë aftësinë për të ofruar udhëzime strategjike, mbikëqyrje teknike, për të ndërtuar ekipe të forta, për të mentoruar stafin dhe për të zhvilluar plane pune;
- Aftësi të shkëlqyeshme ndërpersonale, aftësi për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie efektive të punës me ekipin dhe aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe në ekip;
- Qasje pozitive dhe profesionale: aftësi të shkëlqyeshme organizative, i/e aftë për të punuar në mënyrë të pavarur, në aspektin e marrjes së iniciativave dhe kryerjes së detyrave, dhe udhëheqjes së ekipit;
- I/e vetëmotivuar dhe i/e aftë të jap rezultate me mbikëqyrje minimale;
- Përvoja e punës me projektet e financuara nga BE-ja konsiderohet përparësi;
- Njohuri të shkëlqyera të gjuhës angleze në të shkruar dhe të folur, dhe aftësi të mira komunikimi, në të shkruar dhe në të folur gjithashtu. Gjuha serbe konsiderohet përparësi;
- Aftësi të shkëlqyeshme në përdorimin e kompjuterit, programeve të Microsoft Office: MS Word, MS Excel, MS PowerPoint, Internet, rrjete sociale etj.;
- Njohuri të mira lidhur me të drejtat e fëmijëve;
- Njohuri të mira lidhur me sistemin e shërbimit social;
- Aftësi për të punuar nën presion dhe me afate të shkurtra kohore.

- Posedimi i patentë shoferit (Kategoria B).

**Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë formularin për aplikim të SOS Fshatrave të Fëmijëve Kosovë, CV-në, kopje të diplomave dhe/ose certifikatave dhe letër referencat e punëve të mëparshme, në adresën: HR.Recruitment@soskosova.org
Ju lutemi që ta cekni në titull të emailit: “Koordinator i Projektit”
Do të kontaktohen vetëm kandidatët që hyjnë në listën e ngushtë.
Certifikata e gjykatës që nuk jeni nën hetime do të kërkohet nëse e kaloni raundin e dytë të intervistës.**

Data e fundit për aplikim: 8.9.2022, ora 16:00.

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë është një organizatë joqeveritare për zhvillim social, e cila është aktive në fushën e të drejtave të fëmijëve duke i mbështetur nevojat dhe shqetësimet e tyre që nga viti 1999. Ne ndërtojmë familje për fëmijë pa përkujdesje prindërore, dhe u ndihmojmë atyre që ta formësojnë të ardhmen e tyre dhe marrim pjesë në zhvillimin e komuniteteve të tyre. Për të përmbushur këtë përgjegjësi, ne po kërkojmë kandidat/-e të përkushtuar për pozitën e Koordinatorit/-es të Projektit.

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë zbaton një politikë për PSHEA (mbrojtja nga ngacmimi, shfrytëzimi dhe abuzimi seksual) dhe Rregulloren e Mbrojtjes së Fëmijëve, dhe pret nga punonjësit t'i respektojnë ato, si dhe kërkojnë nga ta të nënshkruajnë një deklaratë me anë të të cilës konfirmojnë respektimin e këtyre politikave. Nënshkrimi i kësaj deklaratë bëhet në të njëjtën kohë kur nënshkruhet kontrata, shoqëruar me një orientim lidhur me proceset e brendshme të PSHEA-së dhe Mbrojtjes së Fëmijëve.

